



QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORË

KARTË – TEKNOLOGJIKE

BRESHKËZA E KALIFORNISË (SAN-JOZE)

Quadriaspidiotus perniciosus (Comst).

Origjina e saj është Kina Veriore. Në Kaliforni është shfaqur në vitin 1873. Në Europë u shfaq në vitin 1928 dhe për herë të parë u konstatua në Hungari. Sot është e përhapur në të gjitha shtetet.

Përhapja:

Breshkëza e kalifornisë (SAN-JOZE), konsiderohet si një ndër dëmtuesit kryesor të pemëve frutore në të gjitha ato vende ku është e përhapur.

Dëmtuesit përhapen nëpërmjet materialit bimor të infektuar nga breshkëza, si fidanë, fruta. Në distanca të afërta mund të përhapet dhe nëpërmjet lëvizjes së larvave. Vatër kryesore për përhapjen e insektit janë fidanishtet frutore dhe pjesërisht degët e frutave të infektuara nga breshkëza. Në infeksionet e lehta është e vështirë të konstatohet dëmtuesi por, dëmtimet nga breshkëza bëhen problem atëhere kur infeksioni përhapet mbi trungun, degët, lastarët, gjethet dhe frutat.

Dëmi:

Pemët e infektuara rëndë nga dëmtuesi kanë zhvillim dhe rritje të dobët, frenohet rritja e lastarëve të rinj si dhe prek gjethet dhe frutat. Shpesh vihen re tharje të pjesëshme të degës ose të kërcellit të bimës e cila ndikon ndjeshëm në prodhimin e pemtoreve. Nga thithja e limfës dhe sekrecioneve toksike që lëshojnë breshkëzat (prej diaspideve), në indet e bimës së prekur, shkaktohen deformime në lastarët e vjetër, çarje të lëkurës, gropa dhe në infeksionet e rënda vërehen frytje në formë galesh, deri në tharje të plotë të bimës. Fruti i infektuar është i mbuluar me njolla të vogla me ngjyrë të kuqërremtë në mesin e të cilave gjenden breshkëza. Kjo karakteristikë dëmtimi shihet mjaft qartë, kryesisht në frutat me ngjyrë të bardhë.

Dëmi që shkakton:

- Prek të gjitha organet mbitokësore të bimës.
- Si pasojë e thithjes së limfës, shkakton deformime në bimë.
- Organet e prekura duken si të mbuluara me hi.
- Është dëmtues polifag, prek më shumë se 150 specie, kryesisht prek kulturat drufrutore si; pjeshkën, mollën, dardhën, kumbullën, kajsin etj.,



Figurë 1. B. e Kalifornisë (SAN-JOZE)



Frut i infektuar

Mënyra e Jetesës:

- Breshkëza ka ngjyrë kafe të zverdhur ose hiri me njollë të verdhë-kafe në mes.
- Dimëron si larvë e moshës së parë.
- Nje femër pjell 50-200 larva të reja, dhe zgjat 6-8 javë, (interferenca e breznive).

Në biologjinë e zhvillimit të insektit ka interes të theksohet fakti që: në të njëjtën

periudhë gjenden breshkëza të **moshave të ndryshme**, ka kryqëzime breznish.

- Në vendin tonë paraziti jep 2-3 brezni në vit.

Breznia e I-rë: fundi i muajit Prillit - fillimi i muajit Maj (kufiri kritik),

Breznia e II-të: fund i muajit Qershor - 10 ditëshi i I-rë i muajit Korrik,

Breznia e III –të: fund i muajit Gusht - fillim i muajit Shtator dhe ciklin e përfundon në fillim të muajit Tetor.



Figurë 2. Degë të infektuara nga breshkëza

Masat e Kontrollit:

- Shërbimet agroteknike:

Kryhen në kohë e me cilësi, është e rëndësishme krasitja e përvitëshme, largimi dhe djegja e degëve.

- Trajtimet dimërore:

Bimët spërkaten me bazë vaji të bardhë mineral, Polisulfur të Ca, Buprofezin 0.2 %, Lanate 0.2 %, Basudin 0.25 %, Sumithion 0.2 % etj.

- Trajtimet vegetative:

Nureled-d me 0.1 - 0.15 ml/100 litra ujë.

Aplaud 25 me 0.1- 0.15 gr/100 litra ujë etj.,

Specialist:

Lumturi Xhelilaj